

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT



Punim diplome master

VLERËSIMI SI PROCES NË ZHVILLIMIN MOTORIK TË NXËNËSVE

Mentori:
Prof.Dr.Hasim Rushiti

Kandidati:
Shaban Sadiki

Prishtinë, 2025

UNIVERSITY OF PRISHTINA
FACULTY OF PHYSICAL EDUCATION AND SPORTS



MASTER'S THESIS

ASSESSMENT AS A PROCESS IN THE MOTOR DEVELOPMENT OF STUDENTS

Mentor:

Prof.Dr. Hasim Rushiti

Candidat:

Shaban Sadiki

Prishtina, 2025

PËRMBJTTJA

1. Hyrje	6
2. LËNDA DHE QËLLIMI I PUNIMIT	10
3. SPECIFIKAT E PËRCJELLJES, KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT.....	11
3.1.Përcjellja	12
3.2.Kontrollimi.....	13
3.3.Metodat e kontrollit	13
3.4. Metodat e matjes	14
3.5. Metoda e vëzhgimit.....	15
3.6. Përmbajtjet e përcjelljes dhe kontrollit	15
3.7. Kontrolli i shëndetit	16
4.VLERËSIMI I AFTËSIVE LËVIZORE	19
5. AFTËSITË FUNKSIONALE	20
6. VLERËSIMI I AFTËSIVE LËVIZORE	20
7. VLERËSIMI I PERFORMANCËS NË DISCIPLINA TË CAKTUAR SPORTIVE	23
8. REZULTATET EDUKATIVE TË PUNËS	26
9. RËNDËSIA DHE ROLI I VLERËSIMIT	27
9.1.PARIMET E VLERËSIMIT	27
9.2.MËNYRA E VLERËSIMIT	28
9.4. Teknikat e vlerësimit	29
9.5. Vlerësimi i nxënësve me shëndet të dëmtuar	31
9.6. ROLI I ARSIMITARIT NË VLERËSIM	32
10. PËRFUNDIMI	35
10.1.Rezume.....	37
10.2 Summary	38
11. LITERATURA	39

Abstrakti

Vlerësimi paraqet njërin prej elementeve më të rëndësishëm në procesin mësimor. Ai është tregues i lëndës shkencore, të shkathtësive të përvetësuara si dhe tregues se sa edukatori, mësimdhënësi ka arritur t'i bartë njohuritë deri te nxënësit. Paraqet një proces shumë të ndjeshëm, i cili është i mbështetur në parime të caktuara, të cilat janë shkencërisht të bazuara. Zbatimi i këtyre parimeve mundëson përmbushjen më të përshtatshme të vetë procedurës së vlerësimit të njohurive. Çdo subjekt në mësimdhënie ka karakteristika të caktuara, të cilat i imponon vetë natyra e subjektit që vlerësohet. Ndër to theksohen edhe edukimi fizik (trupor) dhe kulturës shëndetësore. Prandaj, në këtë punim, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet çështjes së problemit të vlerësimit në mësimin e zhvillimit fizik dhe shëndetit të fëmijëve.

Fjalët kyçe: edukimi fizik, metodat e vlerësimit, nxënësit.

Abstract

Assessment represents one of the most important elements in the teaching process. It serves as an indicator of the scientific content, of the acquired skills, as well as of the extent to which the educator or teacher has managed to transmit knowledge to the students. It constitutes a very sensitive process, which is based on certain principles that are scientifically grounded. The implementation of these principles enables the most appropriate fulfillment of the knowledge assessment procedure itself. Every subject in teaching has specific characteristics imposed by the very nature of the subject being assessed. Among them, physical education and health culture are particularly emphasised. Therefore, in this paper, special attention will be given to the issue of assessment in teaching the physical development and to the health of children.

Keywords: physical education, assessment methods, students

1. HYRJE

Vlerësimi është procedurë përmes së cilës shprehet sukcesi i nxënësve, ose thënë ndryshe vlerësimi i nxënësve është procedurë me të cilën përmes rregullave të verifikuara përcillet zhvillimi i tij edukativo-arsimor dhe përcaktohet niveli të cilin e ka arritur.

Vlerësimi i nxënësve në mënyrë efektive, pre supozon ekzistencën e elementeve të veçanta dhe kriterëve të vlerësimit që do të lejojë pasqyrë të qartë për gjendjen reale të karakteristikave antropologjike, të aftësive motorike dhe arritjeve motorike të nxënësve. Prandaj, vlerësimi në edukimin fizik dhe kulturën shëndetësore duhet të zbatohen në mënyrë që nota të jetë pasqyrë e gjendjes konkrete të nxënësve, matje e vlerave të tij dhe reflektim i personalitetit të tij . Ppyetjet më të zakonshme që imponohen rreth çështjes së vlerësimit janë: çfarë duhet të vlerësohet, si duhet përcaktuar kriteret e vlerësimit, organizimi i vlerësimit, vlerësimi i nxënësve me shëndet të dëmtuar (me nevoja të veçanta), si duhet vlerësuar njohuritë praktike dhe teorike, etj.

Objektivat dhe detyrat e shkollës si në aspektin edukativ e po ashtu edhe aspektin arsimor janë shumë komplekse. Kjo është shprehur edhe në ndryshimin e raporteve ndaj nxënësit, e cili gjithnjë e më shumë po shihet si një subjekt dhe jo si një objekt në procesin edukativo-arsimor.

Njohja dhe përcjellja e zhvillimit të nxënësve, testimi i tyre dhe vlerësimi i suksesit të tyre duhet të jetë i gjithanshëm. Kritika e vlerësimit tradicional është pikërisht në thjeshtësinë e saj sepse janë vlerësuar vetëm njohuritë dhe patjetër duhet zgjeruar edhe me komponentë tjera.

Vlerësimi i rregullt i përparimit të nxënësve është një pjesë integrale e mësimdhënies dhe të nxënësve në shkollë. Ka një larmi të madhe të aktiviteteve për të vlerësuar përparimin e nxënësit, dhe secila përbëhet prej procedurave të veçanta.

Vlerësimi i nxënësve është padyshim një nga detyrat më të vështira "morale" të çdo mësuesi. Praktika tregon se mësimdhënësit kryesisht i përmbahen modelit të vendosur si shabllon në vlerësimin e nxënësve. Nxënësi i cili në fillim të vitit fiton një përshtypje të mirë të mësuesit, mbetet me atë qëndrim deri në fund të vitit shkollor. Shumë rrallë ose asnjëherë nuk ndodh që një nxënës i cili është nën mesatare edhe sikur të mësojë materien e caktuar mësimore, nuk do të marrë notë më të lartë sesa nga ajo që një mësues është mësuar t'ia japë.

Studime të shumta mbi mënyrat e vlerësimit në shkollat fillore dhe të mesme kanë treguar rëndësinë e mënyrave të duhura dhe të përshtatshme të vlerësimit të punës së nxënësve, mbajtjen e shënimeve dhe raportimin e progresit të nxënësve.

Nga procesi kompleks i mësimdhënies nuk mund të ndahen kontrolli dhe vlerësimi e njohurive të nxënësve, kjo është një hallkë e domosdoshme në procesin e marrjes së njohurive, shprehive, shkathtësive dhe aftësive. Të flasësh për vlerësimin është e pamundur që në të njëjtën kohë të mos flasim për kontrollin, sepse këto dy terma janë të lidhur reciprokisht dhe funksionalisht.

Me anë të kontrollit mblidhen informacionet mbi zbatimin e detyrave mësimore, dhe pastaj në bazë të kësaj me notë adekuate vlerësohet niveli i atij zbatimi.

Verifikimi (kontrolli) dhe vlerësimi janë etapat e orës kur mësimdhënësi merr informata kthyesë për rezultatet e aktiviteteve mësimore. Verifikimi duhet të jetë i përhershëm, sistematik dhe gjithëpërfshirës. Me anë të kontrollit mblidhen informacione mbi zbatimin e detyrave të mësimin, dhe pastaj në bazë kësaj me një notë të përshtatshme vlerësohet niveli i atij zbatimi. Testimin (kontrollin) dhe vlerësimin, si koncepte duhet dalluar, por në praktikë duhet gjithmonë të zbatohen së bashku. Do të thotë nuk ka kontroll, nëse nuk ka vlerësim, dhe gjithashtu nuk duhet të jepet nota nëse nuk është kryer verifikimi. Nëse rrënohet uniteti i tyre mund vihet deri tek konflikti në mes mësuesve dhe nxënësve e që eventualisht mund të çojë deri në urrejtje.

Me rastin e kontrollit dhe vlerësimit është e nevojshme për të theksuar cilësitë morale të mësimdhënësve. Bazuar në hulumtimet është konkluduar se një mësues duhet të posedojë: stabilitetin emocional, pjekurinë, inteligjencën, zhvillimin e mendimit abstrakt, emocionin e zhvilluar për detyrë, ndërlíkueshmërinë, etj. Nga cilësia morale e mësimdhënësve në masë të madhe varet vlera dhe përshtatshmëria e notës.



Është e nevojshme të theksohet se me rastin kontrollit dhe vlerësimit të nxënësve duhet përdorur sa më shumë metoda të larmishme dhe forma të testimit. Testimi nuk duhet të jetë një qëllim në vetvete, nuk është vetëm kontrollim i njohurive të nxënësve, por edhe detyrë edukative. Për çdo notë të tij, mësimdhënësi jo vetëm se e vlerëson nxënësin, por ai vlerëson edhe punën e vet që e kryen me të.

Kur flasim për komponentët e një vlerësimi të plotë të nxënësve në mësim, atëherë në mendje duhet të kihet:

- vlerësimi i nxënësve nga mësimitdhënësi,
- vlerësimi i përbashkët i nxënësve nga ana e mësimitdhënësit dhe nga nxënësit,
- vlerësimi reciprok i nxënësve për njëri tjetrin pa pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të mësimitdhënësit në vlerësimin, dhe
- vetëvlerësimi i nxënësve.

Imperativ i didaktikës moderne dhe sistemit bashkëkohor të vlerësimit është ngritja e kapaciteteve për të vlerësuar angazhimin dhe arritjet e njëri tjetrit dhe për t'u vete vlerësuar. Kjo, në njëfarë mënyre do të largonte subjektivizmin dhe do të ulte nivelin e pakënaqësive të nxënësve si rezultat i dyshimeve në vlerësimet joreale të mësimitdhënësit.

Mësimitdhënësi si një organizator dhe udhëheqës i mësimit do të duhej të kontrollonte efikasitetin e funksionimit të mënyrave metodike të punës së tij, gjegjësisht efikasitetin e procedurave të aplikueshme metodike. Shpesh dëgjohet se rezultatet e vlerësimit të nxënësve i tregojnë mësimitdhënësit për mangësitë në punën e tij.

Duke pasur parasysh problematikën e fakteve të mësipërme, me këtë punim do të përpiqem të përshkruaj strukturën e vlerësimit në edukimin fizik dhe shëndetësor, me të gjitha veçoritë e saj, problemet e mundshme që mund paraqiten në vetë problematikën e vlerësimit në mësimin edukimit trupor.

2. LËNDA DHE QËLLIMI I PUNIMIT

Duke analizuar specifikat e procesit mësimor të edukatës fizike është e pamundur që të veçohet vlerësimi si akt përfundimtar, i cili duhet të tregojë se sa e ka zotëruar nxënësi një materie të caktuar, ose që duhet të tregojë se sa mësuesi e ka bërë punën e tij si duhet.

Ashtu si parimet e mësimin të edukimit fizik prapagojnë qasjen individuale ndaj nxënësve, përshtatja e procesit mësimor interesave dhe mundësive të tij, është e domosdoshme një qasje e tillë dhe për vlerësimin e përvetësimin të njohurive të fituara. Ne jemi të vetëdijshëm për faktin se edukimi fizik është një lëmi e caktuar e mësimdhënies që kërkon përgatitjen e hapësirës për ushtrime, mjete materiale, përndryshe as vetë mësimi si dhe segmenti i vlerësimin nuk do të jetë në gjendje për t'u përmbushur plotësisht, dhe për këtë arsye do të mungojnë efektet e plota të procesit mësimor dhe vetë vlerësimi do të humbasë kuptimin. Në kushtet në të cilat ka mungesë për mjetet materiale, hapësirat, vështirë se do të përmbushen detyrat themelore të edukimit fizik, dhe vlerësimi nuk do t'u përshtatet aftësive individuale të nxënësve, por do të vlerësohet më shumë grupi, ndërsa edukatorët do të kenë gjithmonë arsytim pse ata nuk kanë mundur objektivisht t'i vlerësojnë nxënësit. Prandaj, objekti i këtij punimi orientohet në parametrat teorikë që i promovon metodika e edukimit fizik dhe shëndetësor, dhe me të cilët duhet të udhëhiqet mësimdhënësi i edukatës fizike me rastin e procesit të vlerësimin në kushtet optimale të punës:

Lënda e këtij punimi paraqet **vlerësimin në mësimin e edukimit fizik dhe shëndetësor** si një nga dukurit thelbësore të këtij procesi.

Nga definimi i lëndës së punës mund ta definojmë edhe qëllimin e punimit i cili ka të bëjë me **Analizën e strukturës, përmbajtjeve dhe specifikave të vlerësimin të zhvillimit motorik në kuaedër të lëndës e Edukimit fizike dhe shëndetësorë.**

3. SPECIFIKAT E PËRCJELLJES, KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

Sistematikisht dhe në mënyrën e duhur, me veprimin e shumanshëm të operatorëve kineziologjik në zhvillimin antropologjik të fëmijëve është e mundur të arrihen vetëm nëse kemi monitorim të vazhdueshëm, verifikim të efektit të cilin e kanë shkaktuar operatorët kineziologjik për një periudhë të caktuar kohorë, qoftë afatshkurtër apo afatgjatë. Proceset e transformimit paraqesin procese ciklike që shkaktojnë ndryshime në organizëm. Megjithatë, cilat ndryshime janë shkaktuar është e mundur t'i përcaktojmë kur të mirren informata kthyese mbi efektin e stimulimit. Informatat kthyese do t'i shërbejnë edukatorit për të përcaktuar nëse zbatimi i operatorëve të caktuar ka shkaktuar ndryshime që edukatori ka dashur t'i arrijë. Nëse informatat kthyese janë të kundërta nga rezultatet e pritura ,edukatori duhet të bëjë ndryshime në programin e ushtrimeve fizike. Në mësimin e edukimit fizik dhe shëndetësor, efekti i transformimit varet nga një numër i madh faktorësh që mund të ndikojnë dukshëm në rritjen e suksesit së ushtrimeve trupore(fizike) gjegjësisht në zvogëlimin e suksesit nëse lihen anash faktorë të caktuar. Një numër i madh i informatash mbi statusin antropologjik të nxënësve i ofron mundësi edukatorit që me të drejtë të tregojë për mangësitë e mundshme në zhvillimin e nxënësve, të kërkojë ndikimet negative, të cilat nuk i kanë kontribuar transformimit pozitiv. Megjithatë, efektet pozitive të transformimeve të karakteristikave antropologjike, të njohurive motorike dhe arritjeve, mund të jenë nën ndikimin e faktorëve objektivë dhe subjektivë, si më poshtë:

- Gjandja aktuale e statusit antropologjik të nxënësit
- A janë rezultatet a arritura si pasojë e punës ose predispozitave të caktuara natyrore të nxënësit
- Në çfarë kushtesh materiale realizohet programi
- A është përcaktuar programi në tërësi apo pjesërisht,
- Sa ka qenë i varur programi nga kushtet materiale të punës, dhe sa nga mësimdhënësi dhe nxënësit,
- Cili është raporti, qëndrimi i nxënësve ndaj punës, interesat e tij.

Struktura e nënsistemit të përcjelljes (monitorimit) dhe efektit të kontrollit përmban elementet e: përcjelljes kontrollit dhe vlerësimit (Hadžikadunić, 2004, Findak, 1999).

3.1. Përcjellja

Supozimi themelor i udhëheqjes kineziologjike të aktiviteteve të suksesshme është përcjellja (menaxhimi, monitorimi) sistematike e numrit, shkallës dhe strukturës së karakteristikave të caktuara për një afat më të gjatë. Esenca e monitorimit është në krijimin e një baze për programimin aktivitetëve kineziologjike, por edhe në korrektimin permanent të programit mbi bazën e informatave të shfaqura me kohë në bazë të informatave kthyese. Është e rëndësishme të theksohet se sistemi i vërtetuar i përcjelljes në bazë të fakteve që mund t'i shohim nga kartoni i zhvillimit fizik, nuk përfshin segmente të tjera antropologjike të statusit të nxënësit (segmenti psikologjike). Sikur që është bazë formimi i lëvizjeve dhe forcimi i tyre, faktor i rëndësishëm është edhe faktori psikologjik. Për këtë arsye është e vështirë për të marrë informata kthyese pse fëmija ka problem gjatë kryerjes së detyrave të caktuara motorike. Me anë të informatave të shumta për cilindo nxënës, edukatori mundet me motivim të ndikojë tek nxënësit. Duke vënë në dukje mangësitë e mundshme dhe cilësinë në zhvillimin e karakteristikave antropologjike, paraqet një komponentë të rëndësishme në ngritjen e motivimit fillestar dhe të zgjatur për qasje ndaj sportit (Najšteter, 1997). Në praktikën e përditshme mësimore është e pamundur për të përcjellë të gjitha karakteristikat antropologjike, njohuritë motorike, arritjet motorike. Shkaku më i zakonshëm është se institucionet arsimore nuk disponojnë me të gjitha instrumentet, veglat mjetet ndihmëse të nevojshme për të monitoruar dhe verifikuar përmbajtjet e theksuara.

3.2. Kontrollimi

Edukimi fizik është specifik në raport me format tjera të edukimit. Specifika pasqyrohet në faktin se ndikimi arrihet përmes mjeteve specifike dhe të ngjashme për nga natyra e tyre. Në praktikën e edukimit fizik dhe shëndetësor, në varësi të asaj se çka dëshirohet të kontrollohet, kontrollimi mund të jetë inicial apo fillestar, aktual, kalimtar ose periodik dhe matje finale apo përfundimtare (Hadžikadunić, 2004).

Matja fillestare ka funksionin që mësimdhënësi të njihet me nxënësit, sepse vetëm përmes pasqyrës së gjendjes së nxënësve është e mundshme t'i qasemi planifikimit dhe

programimit të procesit mësimor. Matja fillestare zbatohet për arsye të marrjes së informatave mbi cilësinë dhe sasinë e aftësive motorike të nxënësve në fillim të vitit shkollor. Ky vlerësim ka qëllim informues dhe zbatohet vetëm atëherë kur edukatori nuk ka kurrfarë informatash mbi aftësitë motorike të nxënësve me të cilët do të punojë.

Matja aktuale lidhet me verifikimin aktual, dhe ka vetëm qëllim informues. Qëllimi kryesor i verifikimit aktual është vetëm marrja e informacioneve të përgjithshme mbi përvetësimin themelor të strukturës së lëvizjeve, dmth. të lëvizjeve motorike që janë mësuar gjatë orës., por do të ishte mirë që herë pas here në fund të orës të bëhet edhe vlerësimi. Qëllimi i verifikimit aktual është që nxënësve t'u tërhiqet vërejtja për gabimet e mundshme ose të nxirret në pah puna e mirë e tyre.

Matja kalimtare ose periodike është e lidhur gjithmonë me regjistrimin e asaj që kontrollohet. Testimi i karakteristikave antropologjike kërkon regjistrimin e rezultateve, njohurive motorike dhe të arriturat vlerësohen. Me kontrollin kalimtar duhet marrë informata kthyesë: mbi dinamikën e realizimit të detyrave programuese për çdo individ, a janë shkaktuar ndryshime të cilat kanë qenë të parapara me program, si dhe cili është niveli i aftësive motorike dhe arritjeve, si dhe cilat janë rezultatet edukative të punës.

Matja finale ose përfundimtare zbatohet në fund të një periudhe të caktuar kohore, zakonisht përkon me fundin e gjysmë vjetorit ose vitit shkollor. Qëllimi i këtij kontrolli ka për detyrë për të përcaktuar shkallën në të cilën është zbatuar programi dhe cilat janë ndikimet e tij. Të dhënat e fituara shfrytëzohen në rend të parë për vlerësim dhe analizë të rezultateve të përgjithshme në një periudhe të caktuar kohore.

3.3. Metodatat e kontrollit

Ekzistojnë metoda të shumta të cilat mund të masin me saktësi, të kontrollojnë ose të vlerësojnë funksione të rëndësishme dhe ndryshimet që ndodhin në organizëm nën ndikimin e ushtrimit fizik. Ka disa metoda që kërkojnë pajisje të kushtueshme që mund të përdoren, por shumica e shkollave nuk kanë pajisje të shtrenjta. Është e rëndësishme të theksohet se nuk duhet të kemi qasje sipërfaqësore me rastin përcaktimit të gjendjes fillestare, si dhe kontrollit të përgjithshëm pa marrë parasysh se nuk kemi pajisje të shtrenjta. Pra, e rëndësishme është zgjedhja e pajisjeve që do të lejojnë kontrollin optimal të aftësive të nxënësve, sepse verifikimi jo i saktë i gjendjes në të cilën ndodhen nxënësit, mund t'i dërgojë në drejtim të gabuar e që mund të ketë pasoja të rënda, të cilat të mund të bëjnë më shumë dëme sesa dobi

në zhvillimin fizik të nxënësve. Në mësimin e edukimit fizik dhe shëndetësor përdoren më së shpeshti dy metoda të kontrollit të nxënësve: metoda e matjes dhe metoda e vëzhgimit.

3.4. Metoda e matjes

Metoda e matjes është veçanërisht e rëndësishme për zbatimin e suksesshëm të kontrollit të përgjithshëm të mësimin të edukimit fizik dhe shëndetësor.

Me aplikimin e këtyre metodave saktësisht dhe objektivisht mund të përcaktohen karakteristikat individuale dhe aftësitë e nxënësve, gjendja dhe niveli i arritjeve të tyre. Subjekt i matjeve janë zakonisht disa matje trupore individuale, rezultatet tekniko-sportive në disa aktivitete të caktuara motorike ose vetëm disa parametra të atij aktiviteti. Detyrë e këtyre matjeve është për të marrë të dhënat që mund të krijojnë një pasqyrë të përgjithshëm të individit. Në bazë të parametrave të fituar, mund të merren informacione mbi ritmin zhvillimit të individit ose grupit. Të dhënat e fituara i mundësojnë mësimitdhënësit që më lehtë dhe me efikasitet t'i qaset përpunimit të programit, monitorimit të zbatimit të tij dhe kontrollit të besueshëm. Bazuar në këto informacione, mësimitdhënësi në përputhje me nevojën mund të bëjë korrigjime në programin ekzistues, të zbatojë forma të ndryshme metodike të punës. Është e rëndësishme të theksohet se me rastin e zbatimit të teknikave të veçanta të matjes, të përdoren procedura të standardizuara të matjes që janë konfirmuar në veprat shkencore të autorëve të shumtë. Është e rëndësishme që me rastin e përdorimit të metodave të matjes, të njëjtat procedura, gjegjësisht të njëjtat teste duhet shfrytëzuar një kohë të gjatë, sepse vetëm me të njëjtat matje të testeve mund të ndjekim zhvillimin e nxënësve.

3.5. Metoda e vëzhgimit

Metoda e vëzhgimit është një nga metodat më të rëndësishme në praktikën arsimore (pedagogjike). Nuk ka asnjë punë pedagogjike ku mësuesi nuk përcjell dhe vëzhgon punën e nxënësit dhe sjelljet e tij. Që mësuesi të ketë mundësi objektive të vëzhgojë, duhet të përcaktojë me saktësi kriteret e vëzhgimit. Me rëndësi është fakti se nxënësit në klasë janë grup heterogjen, kështu që paraqitet problem më i madh në mbledhjen e të dhënave. Mësuesi duhet t'i njohë mirë nxënësit, si anët negative e po ashtu edhe anët e tyre pozitive. Vëzhgimi duhet të jetë në një anë të plotë dhe gjithëpërfshirës, si dhe në anën tjetër i planifikuar dhe sistematik. Vëzhgimi do të jetë metoda e hulumtimit pedagogjik vetëm në ato raste kur ajo përcakton objektivin dhe subjektin e vëzhgimit, kohën kur një dukuri do të vëzhgohet, mënyrën e vëzhgimit dhe metodën e analizës të të dhënave të marra. Pamundësia për të zbatuar vlerësimin dhe para vlerësimin objektiv, atë vlerësim duhet zbatuar përmes punimit të shkallëve vlerësuese apo përmes testeve motorike të dijes.

3.6. Përmbajtjet e përcjelljes dhe kontrollit

Rezultatet, tek të cilat mund të arrihet me monitorim dhe kontroll mund të kenë funksionin e vet nëse ato janë mbledhur në mënyrë të planifikuar dhe sistematike. Përmbajtja e monitorimit dhe kontrollit duhet të jetë e tillë që të lejojë një pasqyrë të plotë dhe objektive në gjendjen antropomotike të nxënësve. Përmbajtja e përcjelljes dhe kontrollit në edukimin fizik dhe shëndetësor do të ishte optimal në qoftë se do të përfshinte të gjitha karakteristikat antropologjike, aftësitë motorike dhe arritjet, si dhe gjendjen shëndetësore të nxënësve. Megjithatë, mungesa e pajisjeve pamundëson përcjelljen e plotë të nxënësve. Kryesisht përmbajtjet e kontrollit do të duhej të ishin: **gjendja shëndetësore, karakteristikat antropologjike, aftësitë motorike, performanca motorike dhe karakteristikat edukative**. Me rastin e kontrollit dhe përcjelljes është më e besueshme nëse përdoren më shumë variabla në një lëmi të caktuar.

3.7.Kontrolli i shëndetit

Shëndeti është pa dyshim një nga komponentët më të rëndësishme të personalitetit të njeriut. Përcjellja e rritjes dhe zhvillimit së bashku me kontrollin shëndetësor është një detyrë që nuk duhet injoruar, dhe që realizohet nëpërmjet kontrollit të rregullt dhe të detyrueshëm shëndetësor. Para çdo përfshirjeje të nxënësve në ushtrimet fizike është e domosdoshme për të pasur informacione mbi gjendjen shëndetësore të nxënësit. Mësimdhënësi është i obliguar që gjatë punës së drejtpërdrejtë ta përcjellë dhe kontrollojë shëndetin e nxënësve. Kur mësuesi vëren ndryshime të gjendjes shëndetësore duhet menjëherë të reagojë, gjegjësisht t'i njoftojë prindërit, përmes tyre apo drejtpërsëdrejti edhe mjekun mbi situatat që kërkohen.

Mbajtja e trupit është një nga treguesit më të rëndësishëm të shëndetit të njeriut. Mbajtja e keqe e trupit, në mënyrë të pashmangshme çon në çrregullime shëndetësore dhe kapacitetet të reduktuara të punës. Mbajtja e drejtë e trupit më së shpeshti dëmtohet tek moshat e reja shkollore dhe gjatë rritjes intensivë dhe zhvillimit. Kjo është një prej detyrave themelore në mbajtjen e drejtë të trupit. Kjo detyrë e inkurajon mësimdhënësin të ndërmarrë masa të caktuara për të krijuar shprehi tek nxënësit për mbajtjen e drejtë të trupit. Nëse konstatohet keqësimi i mbajtjes së trupit duhet të ketë kujdes të veçantë të këta nxënës dhe duhet zbatuar një gjimnastikë korrektuese. Me rastin e vlerësimit të mbajtjes së trupit në mësimin e edukimit shëndetësor zbatohen kriteret e WOLANSKIT (1975) të cilat mundësojnë vlerësimin e mbajtjes së trupit e që nuk kërkojnë pajisje të shtrenjta.

Gjate vlerësimit të segmenteve individuale zbatohen kriteret për vlerësimin e raporteve ndërmjet tetë segmenteve të trupit me projektimin vizual(Hadžikadunić,2000). Shmangiet klasifikohen sipas madhësisë së saj, ndërsa vlerësohen me pike negative, gjate se ciles:

- 0 pikë tregon se nuk ka deformitete
- 1 pikë tregon shmangje të vogël
- 2 pikë tregon shmangje të theksuar

Për çdo segment të vërejtur Wolanski ka përcaktuar se kur duhet dhënë vlerësim individual ,si më poshtë:

1. Kontrolli i mbajtjes se kokës

- 0 – pingulja e lëshuar nga baza e kockave mbajtëse duhet të bjerë mbi pjesën e sipërme të kafazit të kraharorit,
- 1 – Pingulja e njejtë do të bjerë në gjysmën e poshtme të kafazit të kraharorit
- 2- e njëjta linjë do të bjerë para kafazit të kraharorit.

2. Kontrolli i mbajtjes së supeve

- 0 - Pika qendrore e nyjës së shpatullave (maja e acromionit) me projektim bie mbi gjysmën e fundit të siluetës së qafës,
- 1 - E njëjta pikë i "bie" në siluetën e përparme të qafës
- 2- E njëjta pikë "bie" në siluetën e mollëzës së Adamit.

3. Kontrolli i mbajtjes së gjoksit

- 0 - kafazi i kraharorit është harmonik, zile e fryer
- 1- kafazi i kraharorit është i sheshtë dhe
- 2- deformiteti (gjoks"pule").

4. Kontrolli i mbajtjes së shpatullave

- 0- Shpatullat shtrihen gjatë gjithë sipërfaqes në kafazin e kraharorit,
- 1- Shpatullat „me krahë“ ,dmth. Shpatullat e kandidatit, janë të ndara për një gisht
- 2– Shpatullat e kandidatit janë të ndara për dy gishta

5. Kontrolli i mbajtjes së shpinës(kurrizit)

- 0 – Lakorja fiziologjike normale edhe ne rafshin frontal edhe në ate sagjital,
- 1- Devijimet e shkallës së parë: kifoza, lordoza dhe skolioza,
- 2- Kombinimi i i devijimeve apo individualisht, por në nivelin e shkallës së dytë.

6. Kontrolli i mbajtjes së barkut

- 0- Barku i tërhequr pas brinjve, i lëshuar pas processus xiphodeus **në rafshin sagjital.**
- 1- Barku i fryer para.
- 2- Barku i «varur» (në formë dardhe),muskuj të dobët.

7. Kontrolli i mbajtjes së këmbëve

- 0- Qëndrimi spetni normal: gjunjtë vertikalisht drejt, apo së paku për afërsisht
- 1- Qëndrimi spetni normal: gjunjtë duke tentuar drejt "X" dhe prekin njëri-tjetrin, dhe kanë tendencë për të formuar "O" të paktën sa trashësia e dy gishtave të kandidatit,

- 2- Qëndrimi spetni: pretendim i theksuar i gjunjve drejt "X" ose në mënyrë të konsiderueshme kanë tendencë për të qenë "O" për më shumë se trashësia e dy gishtave të kandidatit(nxënësit).

8. Kontrolli i mbajtjes së shputave

0- sipërfaqja shkelësee shputave në 1/3 të linjës së tërthortë. Vlerësohet me matjen e gjurmëve,

1- sipërfaqja shkelëse ka përfshirë edhe pjesën e dytë

2- sipërfaqja shkelëse ka përfshirë edhe pjesën e tretë.

Kontrollimi i vlerësimit të përgjithshëm,do të kryhet sipas kriterëve (Ëolanskit, 1975), kur

0- pikë minimalisht, deri në 16 pikë maksimalisht.

Shkëlqyeshëm	0 pikë,
Shumë mirë	1-4 pikë,
Mirë	5-8 pikë,
Dobët	9-12 pikë dhe
Shumë dobët	13- 16 pikë

Në rast se vërehen devijime të caktuara është e domosdoshme të bisedohet me prindër dhe mjekun e shkollës,që të ndërmerren masa të duhura me qëllim të ndaljes së përparimit të deformiteteve.

Përveç mbajtjes së trupit,është e domosdoshme që të kemi kujdes edhe në cilësinë e shprehive higjienike,si njërin nga segmentet që mund të çojë deri tek keqësimi i shëndetit të nxënësve.

4. VLERËSIMI I AFTËSIVE LËVIZORE

Aftësitë motorike definoohen si struktura latente motorike që janë përgjegjëse për një numër të pafund të ngjarjeve dhe reagimeve që mund të maten. Dimensionet e fshehura nuk janë të izoluar, por janë të kushtëzuara nga njëra-tjetra dhe gjithsesi ndikojnë në aftësitë e tjera. Në zonën e manifestuar mund t'i vërejmë të izoluar, dhe si të tilla ato mund t'i masim. Është me rëndësi të theksohet se aftësitë motorike nuk janë të kushtëzuara gjenetikisht njëjtë për të gjithë, tek disa është i pranishëm më pak kushtëzimin gjenetik e tek disa mi lartë. Në vlerësimin e aftësive motorike shfrytëzohen një shumëllojshmëri e baterive të testeve. Pasi që vendin tonë nuk ka një sistem të caktuar të përcaktimit të aftësive motorike, kam vendosur për Euro fit bateri të testeve. Arsyeja për këtë qëndron në faktin se Euro fit bateria e testeve është e dizajnuar me qëllim të krijimit të një baterie të standardizuar të testeve për tërë Evropën , në mënyrë që të jetë më e lehtë për të krahasuar gjendjen e aftësive motorike në mes të popujve të ndryshëm kombësive dhe kështu me radhë Kështu që unë kam vendosur për të përshkruar **Euro fit baterinë e testeve**. Vlerësimi i testeve të aftësive motorike bëhet përmes standardeve të përcaktuara që janë bërë në popullatën e gjerë për një moshë të caktuar. (normat e vlerësimit të euro fit baterive të testit gjinden në ueb faqen:

Euro fit bateria e testeve përbëhen nga nëntë teste që mbulojnë një gamë të gjerë të aftësive motorike dhe atë:(Oja P, Tuxworth B, eds. (1995), Hadžikadunić.M.(2000)):

- **Flamingo testi i drejtpeshimit(ekuilibrit);**
- **Prekja me dorë (shpejtësia e lëvizjeve);**
- **Përkulje e trupit para nga pozita e ulur (fleksibiliteti)**
- **Kërcimi së gjatit nga vendi (fuqia shpërthyes)**
- **Forca e shtrëngimit ematur me dinamometër (forca maksimale)**
- **Të ndejurit shtrirë- ulur (fuqia repitative e muskujve të barkut)**
- **Qëndrueshmëria në përkulje 8(fuqia funksionale) dhe**
- **Vrapimi vajtje-ardhje 10x5 metra (shpejtësia,shkathtësia) dhe**
- **Vrapimi 20 metra vajtje-ardhje me përshpejtim(qëndrueshmëria)**

5. AFTËSITË FUNKSIONALE

Aftësitë funksionale përfshijnë lirim e sasisë e duhur të energjisë në pikat të cilat në organizëm mundësojnë mbajtjen e ekuilibrit. Aftësitë funksionale janë përgjegjëse për nivelin dhe stabilitetin e rregullimit të ashtuquajturit Sistemi për transportimin e energjisë në të cilin marrin pjesë veçanërisht sistemi kardiovaskular dhe sistemi i frymëmarrjes. Në aftësitë funksionale dhe në njeriun mund të ndikohet gjatë gjithë jetës të cilat me ushtrime mund të rregullohen. Testi që përdoret për vlerësimin e aftësive funksionale është vrapimi në 20 metra me përshpejtim.

6.VLERËSIMI I SHKATHTËSIVE LËVIZORE

Shkathtësitë lëvizore paraqesin nivelin e përvetësimit të disa teknikave lëvizore që mund të jenë të niveleve të ndryshme. Në këto njohuri mund të ndikohet me ushtrime të përshtatshme apo përsëritjen e strukturave të caktuara derisa njohuritë nuk përvetësohen në nivelin e duhur. Shkathtësitë lëvizore nuk janë nën ndikimin gjenetik dhe tek ato mund të ndikohet vetëm duke ushtruar. Pasi shkathtësitë motorike paraqesin nivelin përvetësimit në një nivel të caktuar, me anë të kontrollit dhe vlerësimit duam të vërtetojmë cila është cilësia e njohurive të fituara. Shkathtësitë motorike mund të jenë të përfshira në matjen fillestare, kalimtare dhe përfundimtare. Me matjen fillestare përpqemi për të përcaktuar nivelin e njohurive që nxënësit i disponojnë. Me matjen kalimtare përpqemi për të marrë informata kthyesë mbi nivelin e tyre pas ndryshimeve ose gjatë zbatimit të programit të ushtrimeve. Elementet e verifikimit të njohurive përcaktohen në bazë të programit të punës operative për çdo klasë veç e veç. Verifikimi më i përshtatshëm i njohurive motorike është përmes testeve të aftësive motorike, ashtu që për çdo notë përcaktohen kriteret, të cilat do të jenë të plotësuara në mënyrë që të përcaktohet vlerësimi. Megjithatë, shpesh ndodh që me rastin e vlerësimit, arsimtari të shfrytëzojë metodën subjektive të vlerësimit.

Parimisht, niveli i përvetësimit të njohurive të fituara motorike në edukimin fizik dhe shëndetësor përcaktohet në këtë mënyrë:

Pamjaftueshëm – nxënësi nuk mund të kryejnë aftësi të caktuara motorike as edhe me ndihmën mesimdhënësit, edhe pse ai/ajo mund të ketë një ide se si kjo lëvizje është kryer.

Mjaftueshëm – Nxënësi mund të kryejë aftësi motorike, por ato janë lëvizje të pakoordinuara (të ashpra, të pakujdesshme) dhe në mënyrë të prerë devijojnë nga strukturat ideale të lëvizjes.

Prandaj në këtë fazë gjatë kryerjes dhe pengesës më të vogël pamundësojnë kryerjen e

lëvizjes. Tek lëvizjet e komplekse të performancës vazhdimisht ndryshojnë nga "i sukseseshëm" deri në përpjekjen e pasuksesshme, dhe secila performancë është e ngarkuar me lëvizje të panevojshme të pjesëve të ndryshme të trupit (vendimtare - gabime shumë të mëdha).

Mirë – nxënësi kryen njohuri motorike, në të cilën pjesë të caktuara të lëvizjeve i kryen në mënyrë korrekte, ndërsa tek të tjerat dukshëm devijon nga trajektorja ideale e lëvizjes (të qenësishme – gabimet e mëdha).

Shumë mirë – nxënësi kryen me rregull detyrën motorike, por ka devijime të parëndësishme nga trajektorja ideale (të parëndësishme - gabime të vogla).

Shkëlqyer – nxënësi kryen me saktësi të plotë detyrën motorike.

Si shembull kam theksuar mënyrat e mundshme të vlerësimit të disa strukturave lëvizëse:

Tërësia mësimore: ECJET, VRAPIMET, HEDHJET, KËRCIMET,

Ecjet – të analizohen lëvizjet, (nevojiten njohuri me bazë biomekanike), punë ritmike me duar dhe këmbë.

Vrapimi -t'i kushtohet vëmendje e veçantë:

1. Marrjes së pozitës së fillimit(startit)
2. startit, përsheptimit fillestar, teknika e vrapimit
3. finishit(fundit)

Kërcimi së larti, kërcimi së gjati

1. faza përgatitore- pozita fillestare dhe hovi
2. faza themelore- reflektimi dhe faza e fluturimit
3. faza përfundimtare- ulja

Hedhjet

1. Marrja e pozitës fillestare(startit)
2. Lëvizjet e hedhjes
3. Ndalimi i lëvizjes pas hedhjes

Shkëlqyeshëm > nëse ushtrimi kryhet pa gabime apo me gabime të vogla në fazën përgatitore apo në fazën prmbyllëse.

Shumë mirë > nëse ka gabime më të vogla në fazën fillestare dhe gabime më të mëdha në fazën përgatitore dhe atë përmbyllëse.

Mirë > gabime më të mëdha në fazën fillestare, dhe gabime më të mëdha në fazën përgatitore dhe fazën përmbyllëse

Mjaftueshëm > në fazën fillestare bën gabime të rënda ose numër më të madh të gabimeve të

ndryshme në të gjithë strukturën e lëvizjes.

Pamjaftueshëm > nëse nuk është në gjendje ta kryejë ushtrimin në asnjë mënyrë.

Elementet gjimnastikore

RROKULLISJE PËRPARA, RROKULLISJE PRAPA, RROTULLIM

Rrokullisja përpara

- shkëlqyeshëm- nëse nxënësi nuk e prek terrenin dhe ndihmohet me duar gjatë ngritjes në këmbë.
- shumë të mirë-në qoftë se nuk e prek terrenin me kokën e tij, por ndihmohet me duar apo anasjelltas
- mirë-nëse koka prek terrenin dhe ndihmohet me duar
- mjaftueshëm- nëse mbështetet kokën në tokë ose bie në kurriz
- pamjaftueshëm -nëse nuk mund ta kryejë rrokullisjen përpara

Elementet e lojërave sportive të hendbollit dhe basketbollit

Udhëheqja e topit me duar

- **shkëlqyeshëm** – nxënësi udhëheq topin si pranë dhe pak para trupit ,e shtrëngon si duhet dhe e pranon, ndërsa shikimi i drejtuar para vetes
- **shumë mirë** – nxënësi udhëheq topin kryesisht si duhet, por shikimin e ka të drejtuar kah topi
- **mirë** – nxënësi gjatë udhëheqjes së topit ka kontroll mbi të, por lëvizjet e dorës dhe pëllëmbëve i ka shumë të ngurta, për ç ‘shkak nganjëherë nuk e shtrëngon topin, por i bie, "i bie shuplakë".
- **mjaftueshëm** - arrin të udhëheqë topin, por nuk e shtrëngon, më shumë i bie, duke mos pasur kontroll të përhershëm mbi topin.
- **Pamjaftueshëm**-nxënësi udhëheq topin para vetes, por nuk e shtrëngon fare, por gjithnjë i bie dhe për këtë arsye nuk arrin ta udhëheq.

7.VLERËSIMI I PERFORMANCËS NË DISCIPLINA TË CAKTUAR SPORTIVE

Vlerësimi i aftësive motorike është përqendruar në vlerësimin e ekzekutimit të saktë teknik të strukturës së caktuar të lëvizjes për ndonjë sport, vlerësimi i të arriturave motorike është kërkesë, ajo pret nga nxënësit realizimin e strukturave të veçanta të lëvizjes në kushte komplekse të cilat më së shpeshti janë të ngarkuara me periudhën kohore të realizimit. Prandaj, përveç aftësive motorike të përvetësuara nga nxënësit pritet edhe zhvillimi i aftësive të caktuara motorike. Fuqia e pamjaftueshme nxënësve do të ndikojë negativisht në hedhjen e topit të basketbollit në mur, edhe pse nxënësi ka një teknikë të përvetësuar mirë të kapjes dhe kalimit të topit. Prandaj, **arritjet motorike** definoohen si bashkim i njohurive motorike dhe aftësive motorike, të cilat shprehen si aftësi për t'u lidhur në aktivitetin motorik konkret dhe që maksimalisht shfrytëzohen për arritjen e rezultateve sa më të mira. (Hadžikadunić 2004 Findak, 1999). Ashtu si arritjet motorike kanë për qëllim arritjen maksimale të rezultateve në disa aktivitete motorike, qëllimi i përcaktimit të kontrollit shihet në verifikimin e mundësive potenciale të nxënësve në disa tërësi mësimore. Prandaj, cilësia e njohurive nuk do të manifestohet në fondin e njohurive, por edhe në aftësinë për të zbatuar njohuritë e fituara në kohën e duhur dhe në mënyrë racionale. Kontrollimi i arritjeve motorike duhet të bazohet në një program të edukimit fizik për secilën klasë veç e veç dhe mund të përfshihen në matjen fillestare, transitive dhe matjen e fundit. Kontrolli i arritjeve motorike bëhet me anë të testeve. Testet e zgjedhura duhet të kenë veti të mira metrike në mënyrë që rezultatet të mund të vlerësohen objektivisht. Elementet e zgjedhur duhet në mënyrën më të mirë të përfaqësojnë tërësinë mësimore që është përpunuar. Për të zbatuar kontrollin e arritjeve motorike mënyra më e përshtatshme është përmes testeve të situatës. Testet e situatës mund të përfshijë një ose më shumë elemente në varësi të asaj se çka dëshirojmë të vërtetojmë. Përveç tjerash kryerja e testeve të tilla nuk parasheh vetëm kohën e kryerjes së një elementi të caktuar, por kërkon gjithashtu edhe mënyrën se si testi do të kryhet. Mënyra e kryerjes të testit kërkon nga nxënësit një nivel të caktuar të përvetësimit të aftësive të caktuara motorike pa të cilat do të jetë e vështirë të kryen me sukses detyrat motorike

Në tekstin më poshtë do të jap një shembull të testeve të cilat mund të shfrytëzohen në vlerësimin e arritjeve motorike në lojërë sportive dhe atletikë (Pavlin. K. Me bashkëpunëtorë 1982):

1. Testet e arritjeve motorike në basketboll

a) Hedhja dhe kapja e topit mbi mur për 30 sekonda

Qëllimi: vlerësimi i shpejtësisë dhe saktësia e manovrimit me top.

Mënyra e testimit: Në një distancë prej 2.5 m për filloristë dhe 3 metra për ata shkollës së mesme nga muri i rrafshët ndodhet një nxënës prapa linjës së shënuar. Me shenjën e matësit, nxënësi me të dyja duart hedh topin në mur dhe kap topin e kthyer nga muri. Këtë punë e bën për 30 sekonda. Numri i topave të hedhur dhe të kapur brenda 30 sec. regjistrohet në kartën personale. Gabimi në hedhjen dhe kapjen e topit nënkupton ndërprerjen e kryerjes së testit. Nxënësi ka të drejtë në dy përpjekje, të dy rezultatet do të regjistrohen në procesverbal. Matjen e kryen një matës, i cili njëherit është edhe procesmbajtës.

Mjetet ndihmëse mësimore: topi i basketbollit, kronometri, mjeti për shenjimin e vijës.

Udhëheqja e topit në sllallom

Qëllimi: vlerësimi i shpejtësisë dhe koordinimi.

Mënyra e testimit: Në dysheme vizatojmë një vijë të drejtë në gjatësi prej 12 m të .Në 3 m nga fillimi, njërin pas tjetrit vendosim katër kone. Në sinjalin e matësit, nxënësi niste me topin nga vija e fillimit, e udhëheqë nga ana e jashtme e konës, përshkon konën përfundimtare dhe në të njëjtën rrugë përsëri kthehet në pozicionin e fillimit. Nxënësi e kryen testin dy herë. Para fillimit të testit nxënësi duhet t'i përmbahet udhëzimeve të sakta, për shembull nxënësi nuk duhet të nisët nga fillimi para fishkëllimës, konet që qëndrojnë rreth të cilëve udhëhiqet topi nuk duhet të rrëzohen. Matësi i kohës është gjithashtu edhe startuesi që ndodhet në vijën e fillimit.

Mjetet ndihmëse mësimore: topi i basketbollit, kronometri, mjeti për shenjimin e vijës, konet për sllallom.

Hedhja e topi në kosh në kohën prej 30 sekondash (OKBLK)

Qëllimi: Vlerësimi i aftësisë i hedhjes së suksesshme të topit të basketbollit në kohë të kufizuar

Mënyra e testimit: Nxënësi e hedh topin në kosh me cilëndo teknikë dhe nga cilado distancë. Nxënësi qëndron nën kosh dhe nga çfarëdo pozite e hedh topin në kosh dhe sa më shpesh në distancë prej 30 sekondash. Çdo kosh numërohet si pikë e cila shënohet në procesverbal. Një matës mat kohën dhe njëherit është edhe procesmbajtës.

Mjetet ndihmëse mësimore: topi i basketbollit, koshi dhe kronometri.

Testet e arritjeve motorike në hendboll

a) Hedhja dhe kapja e topit në mur në kohëzgjatje prej 30 sekondave (ORBLZ)

Qëllimi: vlerësimi i shpejtësisë dhe saktësia në përdorimin e topit.

Mënyra e testimit: Në mur vizatohet katrori me madhësi 50x50 centimetra, linja sipërme e katrorit është në largësi prej 2 metrash. Nxënësi me dorën më të mirë hedh topin në katror, topin e kthyer sërish e kap dhe prapë e hedh. Detyra kryhet në afat prej 30 sekondash. Në procesverbal regjistrohet numri i hedhjeve të arritura në afat prej 30 sekondash. Gjuajtjet jashtë katrorit nuk numërohen. Në një distancë prej 3 metrash nga muri vizatohet një vijë e drejtë nga e cila hidhet në katror. Numri i gjuajtjeve dhe i kapjes së topit në afat prej 30 sekondash regjistrohet në rubrikën e përcaktuar. Gabimet gjatë hedhjes apo kapjes, ndërpresin testin. Nxënësi ka të drejtë në dy përpjekje, ndërsa rezultati më i mirë regjistrohet në procesverbal. Matjen e kryen një matësi cili njëherit është edhe procesmbajtës.

Mjetet ndihmëse mësimore: topi për hendboll, kronometri, katrori në mur dhe shenjëzimi në dyshe.

Testet e arritjeve motorike në atletikë

Vrapimi në 60 metra

Qëllimi. Përcaktimi i shpejtësisë së vrapimit në 60 metra

Mënyra e testimit: Nxënësi në shenjën “tashti”(tani) vrapon në distancë prej 60 metrash. Për të ndaluar kohën, duhet për të kaluar vijën e cakut (finishit.) Vrapimi bëhet nga nisja (starti) (i) e lartë.

Mjetet ndihmëse mësimore: bilibili dhe kronometri.

Në vlerësimin e të arriturave motorike tek nxënësit është vështirë për të aplikuar në

vazhdimësi të njëjtat standarde të vlerësimit. Me qëllim përshtatjes e aftësive mësimore të nxënësve dhe vlerësimit të arritjeve të tyre, rekomandohet që të regjistrohen rezultatet më të mira dhe më të dobëta dhe që diferenca e fituar të përpjesëtohet me katër:

- Rezultati më i mirë 8,08
- Rezultati më i dobët 11,03
- Hiqet më i miri nga më i dobëti $11,03-8,08= 2,05$
- 2.05 përpjestohet me katër (nota nga 2-5) = 0,62 (6)
- Përfshirja në rezultatet:
 - 8,08-9,04 = shkëlqyeshëm
 - 9,05-10,01 = shumë mirë
 - 10,02-10,08 = mirë
 - 10,09- 11,05 = mjaftueshëm

8.REZULTATET EDUKATIVE TË PUNËS

Duke qenë se edukimi është proces i vazhdueshëm, ndërsa mundësitë e veprimit edukativ në kulturën shëndetësore të trupit janë të mëdha , punën me nxënës duhet organizuar dhe kryer në mënyrë që gjatë orëve dhe gjatë formave tjera të organizimit të punës duhet siguruar një veprimtari të përhershme edukative për nxënësit. Edukimi i nxënësve është pjesë integrale e punës e të gjithë mësimit, jo vetëm e mësuesve të edukimit të kulturës trupore. Edukimi i nxënësve është aktivitet i planifikuar, veprimtari sistematike dhe e qëllimshme e çdo mësuesi. Ashtu edhe në edukimin fizik, duhet ndërmarrë çdo përpjekje për të siguruar aktivitetet edukative dhe rezultate më të mëdha të mundshme në punën edukative me nxënësit. Duke qenë se rezultatet edukative të punës, mësimit i vlerësojnë në bazë të vëzhgimeve subjektive duhet të përcaktoheni për monitorimin dhe vlerësimin e atyre variablave edukative që janë specifike për këtë fushë edukative, por edhe realisht të matshme.

- Aktiviteti i nxënësve në mësimin e edukimit të kulturës trupore
- Bashkëpjesëmarrja e nxënësve në aktivitetet jashtëmësimore të edukimit të kulturës trupore
- Shprehjet e fituara higjieniko-shëndetësore
- Njohuritë teorike

9. RËNDËSIA DHE ROLI I VLERËSIMIT

Vlerësimi është proces me të cilin me mënyrat e përcaktuara përcillet dhe kontrollohet jo vetëm shkalla e realizimit të detyrave të programit të synuar, por edhe efektet e programit. Vlerësimi duhet të jetë i bazuar në përcjelljen e gjithanshme dhe permanente të nxënësit, me matje në kritere objektive dhe duke respektuar karakteristikat e tyre individuale. Vlerësimi në edukimin fizik duhet të zbatohet ashtu që vlerësimi të jetë pasqyrë e gjendjes aktuale të nxënësve, matje e vlerave të tij dhe pasqyrim i personalitetit të tij. Vlerësimi nuk tregon vetëm suksesin e nxënësve, por në një masë të caktuar shpreh vlerësimin dhe shkathtësitë e mësimdhënësve dhe cilësinë e punës mësimore në përgjithësi. Vlerësimi është një segment i rëndësishëm nga i cili në masë të madhe varet planifikimi dhe programimi i punës edukativo-arsimore, zbatimi i tij dhe korrigjimet e mundshme.

Vlerësimi tregon suksesin e realizimit të qëllimeve dhe detyrave të tij në formimin e personalitetit të nxënësve dhe për këtë arsye është proces jashtëzakonisht i ndërlikuar dhe veprimtari e përgjegjshme. Që vlerësimi të jetë karakteristikë objektive e aktiviteteve kinezologjike të nxënësit, duhet të bazohet në planifikimin dhe monitorimin sistematik, Vlerësimi paraqet pjesën përfundimtare të kontrollit, gjegjësisht me vlerësim shprehet efekti përfundimtar i kontrollit. Mësimdhënësit me rastin e vendosjes së vlerësimit duhet të kenë parasysh të gjithë faktorët që kontribuojnë për një ndikim pozitiv ose negativ në vlerësim, në zbatimin e vlerësimit në sa më shumë tregues që lejojnë krijimin e një momenti pozitiv motivues tek nxënësit për të luftuar për notë, gjegjësisht të motivohen për ushtrime fizike.

Llojet e vlerësimit

Kontrollimi i rezultateve të arritura në shumicën e rasteve bëhet në bazë të tabelave normative nga të cilat lexohet nota, dhe kjo referohet në bazë të rezultateve të arritura të nxënësit.

Vlerësimi në edukimin fizik mund të jetë: paravlerësimi, vlerësimi aktual, periodik dhe përfundimtar.

Para vlerësimi ka të bëjë me vlerësimin fillestar, i cili synon për të marrë informacione mbi nivelin e aftësive me të cilat disponojnë nxënësit. Në bazë të atyre vlerësimeve i qasemi punimit të programit të ushtrimeve të përshtatur sipas mundësive dhe njohurive të nxënësve.

Vlerësimi aktual kryhet drejtpërdrejt në orët e ushtrimit fizik. Ky vlerësim është më tepër informativ dhe shërben kryesisht si një nxitje për punë në të ardhmen. Është mirë që ndonjëherë nxënësit të përfshihen në vlerësimin aktual, me të cilin përmirësohen aftësitë për të vëzhguar, nga ana tjetër ndikon në rritjen e interesit të tyre në punë.

Vlerësimi periodik - qëllimi i këtij vlerësimi është të informojë nxënësit për rezultatet e punës së tyre të gjertanishme, dhe gjithashtu shërben si një orientim për punë të mëtejshme. Zbatohet gjatë vitit shkollor.

Vlerësimi final ose përfundimtar - nënkupton vlerësimin në fund të gjysmë vjetorit apo në fund të vitit. Nëse vlerësohet vazhdimisht gjatë gjithë vitit shkollor, atëherë do të mund të thuhej se ky vlerësim është përmbledhje e tërë gjendjes faktike, të vëzhgimit objektiv dhe kontrollues.

9.1.PARIMET E VLERËSIMIT

Për të qenë nota sa më objektive gjatë vlerësimit, u përmbahemi disa parimeve të caktuara të vlerësimit: Vlerësimi duhet të jetë individual, duhet të jetë i gjithanshëm, sistematik, real, i drejtë dhe publik.

Parimi i individualitetit-

Vlerësimi duhet të jetë individual. Në mesin e nxënësve ka ndryshime në karakteristikat antropologjike, në aftësitë motorike dhe arritjet, si dhe në efektet edukative të punës. Për çdo nxënës duhet ndaras të vlerësohet realizimi i disa detyrave të caktuara, që të mund të merret një pasqyrë më e mirë në nivel, dmth, cilësia dhe sasia e detyrave të realizuara dhe efektet e tyre.

Parimi i shumanshmërisë –

Nëse dëshirojmë që nota përfundimtare të jetë objektive, atëherë vlerësimi i shumanshëm është njëri nga kushtet. Duhet të monitorohen dhe kontrollohen variablet, elementet dhe përmbajtjet në bazë të cilave do të jetë i mundur gjykimi objektiv mbi shkallën e realizimit të të gjitha detyrave, nga ato antropologjike deri tek ato edukative, arsimore dhe shëndetësore.

Parimi i sistematizitetit-

Vlerësimi duhet të kryhet në mënyrë të planifikuar dhe të vazhdueshme, pra, të organizuar dhe sistematikisht nga fillimi deri në fund të vitit shkollor. Kjo u mundëson nxënësve dhe mësuesve që vazhdimisht të informohen për rezultatet e punës së tyre, njëje rit ua mundëson që sipas nevojës të korrigjojnë punën e tyre, që siguron informata kthyesë relevante

mbi efektet e ndërhyrjeve të bëra, të gjitha këto për arritjen e rezultateve sa më të mira në punë.

Parimi i realitetit –

Nota dhe vlerësimi gjithnjë dhe në çdo moment duhet të jenë pasqyrë e gjendjes reale, matje objektive e vlerave dhe tregues real i aftësive të nxënësve, vetive, njohurive, arritjeve dhe kontributit në punë. Çdo nxënës duhet vlerësuar sipas meritave. Vlerësimi joreal, që në të shumtën e rasteve shprehet në „faljen“ e notave, shkakton efekte të kundërta nga të gjitha të tjerat, për të cilat syzohet se do të arrihen. Në vend të vlerësimit joreal, duhet t'i kthehemi vlerave të drejta, të vlerave reale në zbatimin e këtyre veprimeve, ndërsa njëri prej kushteve themelore për këtë është që vlerësimi duhet të jetë real.

Parimi i korrektësisë –

Është jashtëzakonisht i rëndësishëm për bashkëpunim të mirëfilltë në mes të nxënësve dhe mësimit, besimit të ndërsjellët dhe suksesit në punë dhe të vlerësimit të drejtë. Kërkesa themelore për një vlerësim të drejtë është për të "çliruar" atë nga të gjitha që me vlerësimin e nxënësve nuk ka të bëjë asgjë, për shembull, vlerësimi nga mësimit sipas suksesit të nxënësve në lëndë të tjera, vlerësimi vetëm në bazë të përshtypjeve, sipas disponimit të mirë apo të keq të mësimit, etj. Nxënësit duhet të vlerësohen vetëm dhe veçanërisht mbi bazën e informacionit, të dhënave, rezultateve dhe të dhënave të evidencuara të përcjelljes dhe verifikimit (kontrollit). Vlerësimi i drejtë është në parim vlerësim me porosi (mesazh) vlerësim që motivon, ndërsa vlerësimi i padrejtë, de motivon dhe seriozisht vë në pikëpyetje jo vetëm autoritetin, por edhe personalitetin e mësimit.

Parimi i transparencës(publikut)-

Vlerësimi dhe nota duhet t'u bëhen të ditura(njohura) dhe të qasshme (në dispozicion) për nxënësit. Vetëm në këtë mënyrë nota për nxënësit mund të paraqesë informatën kthyesë për gjendjen aktuale të arritjeve të tyre, që të jenë krijues të punës dhe nxitje për punën e tyre të ardhshme. Një nga përparësitë krahasuese të vlerësimit buron nga publikimi i vlerësimit, gjithçka është "e prekshme", dhe me të vërtetë nuk ka asnjë justifikim që edhe nota mos të jetë e atillë, d.m.th publike.

Duke ndjekur parimet e vlerësimit ,nxënësve u jepet mundësia për të fituar besimin në vetvete dhe ndaj mësimdhënësve.

9.2.PËRMBAJTJA E VLERËSIMIT

Për të arritur objektivin e përcaktimit të shkallës së realizimit të detyrave programore, si dhe efekteve të programit të çdo nxënësi në veçanti, është jashtëzakonisht e rëndësishme që të kihet kujdes për përmbajtjen e vlerësimit, të cilat duhet t'u përshtaten kushteve në të cilat zhvillohet mësimi dhe pajisjeve dhe mjeteve ndihmëse në dispozicion. Kjo çështje është veçanërisht e rëndësishme për dy arsye kryesore:

a) në lidhje me arritjet thelbësore të shkencës sot është e nevojshme që me vlerësim të përfshihen të gjitha aftësitë e matshme objektive, vetitë, njohuritë, arritjet dhe variablet edukative që janë të njohura që përmes tyre mund të ndikohet se janë të rëndësishme për shëndetin e nxënësve dhe që nxënësve mund t'u shërbejnë në jetën e përditshme, qoftë në lojë, në argëtim, në përgatitjen për profesionin e ardhshëm ose të mësuarit d.m.th. të punës, dhe

b) ndryshe nga të gjitha fushat e tjera edukativo-arsimore, në të cilat vlerësimi kryesisht mbështet në njohuritë e nxënësve, dhe se nota në esencë është vetëm pasqyrë e njohurive të nxënësve, në vlerësimin e edukatës fizike vlerësimi do të duhej të ishte rezultat, ndërsa nota tregues i ndryshimeve të përgjithshme të cilat janë shfaqur ose jo tek nxënësit si rezultat i punës së përgjithshme edukativo-arsimore.

Vlerësimi në fakt do të duhet të jetë një tregues, informatë kthyesë për nxënësit dhe mësimdhënësit në lidhje me atë se çfarë rezultatesh ka arritur nxënësi. Për të arritur këtë, është e nevojshme që me vlerësim, në njërën anë të përfshihen të gjitha detyrat që mund të realizohen, e në anën tjetër me anë të notës për të shprehur vlerësimin jo vetëm të asaj se sa

çdo nxënës është afër ose largë arritjeve të detyrave programore. d.m.th. zbatimit të programit të vet, por edhe se çfarë janë efektet e programeve të tij.

9.3.MËNYRA E VLERËSIMIT

Në edukimin fizik zbatohen tri metoda të vlerësimit: numerike, përshkruese dhe e kombinuar.

Vlerësimi numerik- me të cilin sukcesi shprehet me nota numerike prej 1 deri 5.

Vlerësimi përshkrues- me të cilin sukcesi shprehet me notë me shkrim.

Vlerësimi i kombinuar- me të cilin vlerësimi shprehet me ndihmën e numrave dhe notave përshkruese.

9.4 Teknikat e vlerësimit

Në teknikat e vlerësimit është e nevojshme të përgjigjemi në dy çështje:

1. Si duhet kryer një vlerësim përfundimtar ose çfarë të marrin në konsideratë dhe çka duhet të udhëhiqemi me rastin e vendosjes së notës përfundimtare?
2. Si duhet bërë diferencimi i notës?

Nota përfundimtare duhet të bazohet në tregues objektivë të monitorimit, vlerësimit dhe notimit të nxënësve. Vetëm një notë e tillë përfundimtare mund të jetë një tregues objektiv i gjithë asaj që ka ndodhur në një periudhë të caktuar. Që ajo të jetë e këtillë, duhet të përmbajë rezultatet dhe elementet e vlerësimit të të gjitha komponenteve që kanë qenë të përfshira në përcjellje, kontrollim dhe vlerësim.

Për ta bërë më të drejtë notën përfundimtare duhet që përveç faktorëve objektivë të mirren parasysh edhe faktorët subjektivë, si p.sh.: si ka qenë gjendja shëndetësore e nxënësve gjatë vitit shkollor, në çfarë kushtesh është zhvilluar mësimi i edukimit të kulturës trupore, a janë zbatuar kushtet më të përshtatshme gjatë përcjelljes, kontrollimit dhe vlerësimit, cili ishte raporti i nxënësve ndaj punës, etj. Faktorët subjektivë duhet marrë parasysh aq sa mund të kontribuojnë në objektivitetin e notës (vlerësimit).

Pavaraësisht preja asaj se a shprehet sukcesi i nxënësve numerikisht, me përshkrim apo me notë të kombinuar, nota përfundimtare mund ta përmbush funksionin e saj vetëm nëse është shprehje reale ndaj punës së nxënësve, nëse është tregues objektiv i përparimit të tij dhe

udhërfyës i besueshëm për punën e mëtejme të tij dhe aktivitetit në fushën edukativo arsimore dhe fizike e shëndetësore.

2. Diferencimi i notës ka të bëjë me çështjen kur mësuesi ta vlerësojë nxënësin me notën shkëlqyeshëm, shumë mirë, mirë dhe mjaftueshëm dmth. një notë të tillë apo të atillë. Që arsimtari ta zbatojë diferencimin në mënyrën më të mirë, njëlloj a ka të bëjë me vlerësimin numerik, përshkrues apo të kombinuar, është e nevosjhme që t'u përmbahet gjashtë kritereve:

- a) duhet të vlerësojë dhe përcaktojë se a i ka realizuar çdo nxënës qëllimet e definuara dhe detyrat e programit apo jo,
- b) duhet vlerësuar dhe përcaktuar se a e ka përvetësuar çdo nxënës programin themelor apo jo,
- c) a ka ndryshime në karakteristikat antropologjike nga gjendja fillestare deri te ajo finale, e nëse po, çfarë përparimi është arritur,
- d) duhet vlerësuar dhe përcaktuar cila është cilësia e njohurive motorike e çdo nxënësi dhe a janë përmirësuar arritjet motorike,
- e) cilat janë efektet e punës edukative të çdo nxënësi veç e veç,
- f) duhet vlerësuar dhe përcaktuar tërë punën dhe përparimin në periudhën kur nxënësi është vlerësuar.

9.5. Vlerësimi i nxënësve me shëndet të dëmtuar

A duhet që nxënësit me shëndet të dëmtuar t'i nënshtrohen regjimit të vlerësimit apo jo? Këto dhe mendime të ngjashme dhe qasja në vlerësimin e nxënësve me shëndet të dëmtuar kanë pasojë dhe se kësaj çështjeje duhet qasur në mënyra të ndryshme:

- nga situatat që nxënësit me shëndet të dëmtuar mos të vlerësohen, deri te rastet që të vlerësohen vetëm me nota përshkruese,
- deri tek shembujt që ata të vlerësohen si të gjithë nxënësit tjerë.

Ligji mbi edukimin dhe arsimin themelor nuk parasheh lirin e nxënësve me shëndet të dëmtuar nga mësimi i edukimit të kulturës trupore, e as nga vlerësimi. Nxënësit me shëndet të dëmtuar mund të lirohen vetëm nga ndonjë pjesë e programit të edukimit të kulturës trupore. Kjo do të thotë se nxënësit me shëndet të dëmtuar marrin pjesë në mësimin e edukimit të kulturës trupore. dmth janë të përfshirë në punën dhe realizimin e pjesës së rregullt të programit ose programit të veçantë, në pajtim me shkallën apo karakterin e dëmtimit të shëndetit të tyre. Në qoftë se një nga qëllimet dhe detyrat e edukimit fizik themelor është përmirësimi i shëndetit të nxënësve, përparimi i shëndetit të nxënësve mbahet që vlerësimi i

nxënësëve me shëndet të dëmtuar në arsimin fizik duhet të jetë një avantazh e jo një disavantazh. Kjo mënyrë ofron një mundësi për nxënësit me shëndet të dëmtuar t'i nënhtrohen monitorimit dhe verifikimit sistematik. Për më tepër, mund të pritët që rezultatet e marra për këta nxënës, por edhe për mësuesit janë të paçmueshme jo vetëm për marrjen e informatave kthyesë për arritjet në edukimin e kulturës trupore, por edhe ndryshimet ose përmirësimin e shëndetit të tyre nën ndikimin e ushtrimit fizik.

Tek vlerësimi dhe vendosja e notës përfundimtare të nxënësve me shëndet të dëmtuar duhet të kemi kujdes për: shkallën dhe karakterin e dëmtimit të shëndetit të tyre, gjegjësisht duhet ta kryejmë përcjelljen dhe kontrollin e punës së tyre, dmth rezultatet e punës dhe përparimin. Prandaj, çka do të monitorohet dhe kontrollohet, kur dhe në çfarë mënyre varet kryesisht nga dëmtimi pastaj çfarë dhe sa çdo nxënës individualisht me shëndet të dëmtuar ka punuar dhe kontribuar në përmirësimin e shëndetit të tyre.

1. 9.6.ROLI I ARSIMITARIT NË VLERËSIM

Duke respektuar të gjitha rregullat dhe parimet, duke marrë parasysh faktorët objektivë dhe subjektivë të vlerësimit, duke iu referuar vlerësimit si një proces i gjallë, pyetja është se çfarë është roli i arsimtarëve. Megjithatë, mësuesi është ai që përfundimisht e formulon notën (vlerësimin). Profesionalizmi i arsimtarit është bazë themelore për një vlerësim të suksesshëm. Pa njohjen e plotë të profesionit, sidomos të ligjshmërisë që lidhet me monitorimin, vlerësimin nuk mund të pritet as zbatimi i suksesshëm i procesit pedagogjik. Faktori subjektiv do të jetë më pak i pranishëm në vlerësim nëse arsimtari ndaj procesit të vlerësimit ka qasje profesionale. Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet se kushtet e punës mund të ndikojnë dukshëm në procedurat që lidhen me vlerësimin e nxënësve, kushtet më mira të punës, japin mundësinë gjithëpërfshirëse të përcjelljes dhe kontrollit ,e cila rezulton në një vlerësim më të mirë. Për të krijuar raporte konkrete për vlerësimin e nxënësve, duhet marrë parasysh nxënësin si tërësi. Kjo i referohet të gjitha informatave të tjera që duhet t'i kemi në mendje gjatë vlerësimit. Në qoftë se keni më shumë informata për nxënësit supozohet se do t'i njohim më mirë të njëjtit që do të mundësonte edhe të kemi një gjykim më objektiv.

10.PËRFUNDIMI

Struktura e nënsistemit të përcjelljes dhe kontrollit efektiv përmban elemente: të përcjelljes, kontrollit dhe vlerësimit(notimit). Kuptimi i përcjelljes është në krijimin e bazamentit për programimin e aktiviteteve kineziologjike, por dhe ndaj përmirësimit të përhershëm të programit të bazuar në informacionet e paraqitura me kohë në bazë të informatave kthyesë. Me një sasi të madhe informacionesh për çdo nxënës, edukatori mund në mënyrë të motivuar të ndikojë tek nxënësit. Duke vënë në dukje mangësitë e mundshme dhe të cilësisë në zhvillimin e karakteristikave antropologjike, përcjellja paraqet komponentë e rëndësishme për krijimin fillestar dhe motivimin e zgjatur për qasje ndaj sportit.

Në praktikën e edukimit fizik dhe shëndetësor, në varësi të asaj se çka duam të verifikojmë, kontrollimi mund të jetë:

inicial apo fillestar,
aktual(i tanishëm),
kalimtar ose periodik dhe
final apo matje përfundimtare.

Ekzistojnë metoda të shumta me të cilat mund të maten me saktësi, kontrollohen ose të vlerësohen karakteristikat e rëndësishme dhe ndryshimet që ndodhin në organizëm nën ndikimin e ushtrimit fizik. Në mësimin e edukimit fizik dhe shëndetësor përdoren kryesisht dy metoda të kontrollimit të nxënësve: metodat e matjes dhe metodat e vëzhgimit. Me zbatimin e këtyre metodave të matjes me saktësi dhe objektivisht mund të përcaktohen karakteristikat individuale dhe aftësitë e nxënësve, gjendja dhe niveli i arritjeve të tyre. Metoda e vëzhgimit është një nga metodat më të rëndësishme në praktikën pedagogjike dhe me qëllim të aplikimit të përshtatshëm duhet të specifikohet lënda dhe qëllimi i vëzhgimit. Përmbajtjet programore përcaktojnë edhe përmbajtjet e kontrollit mësimin e edukimit fizik, ndërsa përmbajtjet e kontrollit do të duhej të ishin: gjendja shëndetësore, karakteristikat antropologjike, aftësitë motorike, performanca motorike dhe karakteristikat edukative. Gjatë kontrollit të përmbajtjes është e nevojshme për të përdorur instrumente të caktuara, si dhe teste të standardizuara që do të mundësojnë vlerësim cilësor dhe objektiv. Mungesa e burimeve materiale mund të vështirësojë procesin e vlerësimit objektiv, i cili kërkon përpjekje shtesë të arsimtarëve për të vlerësuar nxënësit dhe për të vepruar në motivimin e tyre. Të dhënat e mbledhura është e nevojshme të regjistrohen. Evidencimi duhet të jetë i rregullt dhe i kontrolluar për të mundësuar vëzhgimin e ndryshimeve në zhvillimin e nxënësve. Çdo nxënës duhet të ketë kartonin e tij.

Vlerësimi ndodh si akti përfundimtar i monitorimit dhe verifikimit. Ky vlerësim do të mbetet objektiv nëse gjatë vlerësimit i përmbahemi parimeve të vlerësimit:

(individualitetit, transparencës, shumanshmërisë, sistematizitetit, drejtësisë dhe realitetit). Gjatë vlerësimit mund të përdorim nota përshkruese, numerike dhe të kombinuara. Gjatë formimit të notës është e domosdoshme për të vendosur kritere, të cilat do të lejonin diferencimin e nxënësve dhe në këtë mënyrë do të ndikonin në mënyrë motivuese tek nxënësit. Në vetë procesin e vlerësimit, është e pamundur për të lënë anash arsimtarin, i cili me përgatitjen dhe profesionalizmin e tij do të ndihmojë në vlerësimin objektiv dhe të drejtë të nxënësve.

Rezyme

Bazuar në materialin e trajtuar në këtë punim si dhe praktikën e edukimit fizik dhe shëndetësor, në varësi të asaj se çka duam të vlerësojmë dhe verifikojmë, kontrollimi mund të jetë: *inicial apo fillestar, aktual(i tanishëm), kalimtar ose periodik dhe final apo matje përfundimtare.*

E rëndësishme është që gjatë kontrollit dhe vlerësimit është e nevojshme për të përdorur instrumente të caktuara, si dhe teste të standardizuara që do të mundësojnë vlerësim cilësor dhe objektiv të nxënësve.

Meqenëse vlerësimi i informatave lëvizore te të rinjër është proces mjaft kompleks, gjatë vlerësimit patjetër duhet përmbajtur parimeve të vlerësimit të cilët janë të përshkruara në punim.

E rëndësisë së veçantë është gjithashtu evidentimi i informatave mbi gjendjen e statusit të zhvillimit lëvizorë në kartonin personal të secilit nxënës, në mënyrë që të përcjelllet evaluimi i zhvillimit të fëmijëve deri në fund të mbarimit të ciklit shkollorë.

Gjithashtu, përveq zgjedhjes së testeve të vlerësimit të karakterit të përgjithshëm, të zgjedhen teste të përshtatshme dhe në përputhjen e përmbajtjeve të kurikulave , si dhe përshtatja e testeve sipas moshës kronologjike.

ASSESSMENT AS A PROCESS IN THE MOTOR DEVELOPMENT OF STUDENTS

Summary

Based on the material addressed in this paper, as well as the practice of physical and health education, depending on what we aim to assess and verify, assessment can take several forms: *initial or introductory, current, transitional or periodic, and final or conclusive measurement.*

It is important that during the assessment and evaluation, specific instruments and standardised tests are applied, which enable a qualitative and objective evaluation of students. Since the assessment of motor information among young people is a rather complex process, it is essential to adhere to the principles of assessment outlined in this paper. Of particular importance is also the documentation of information on the status of motor development in each student's personal record card, in order to monitor children's development throughout the entire school cycle.

In addition to the selection of general assessment tests, it is also necessary to select appropriate tests aligned with curriculum content, as well as adapt them according to the students' chronological age.

11.LITERATURA

1. Eurofit, (1993), Eurofit Tests of Physical Fitness, 2nd Edition, Strasbourg
2. Findak V. (1999): Metodika tjelesne i zdravstvene kulture, Školska knjiga, Zagreb.
3. Hadžikadunić M i Mađarević M.: Metodika tjelesnog odgoja sa osnovama fiziologije vježbanja. Zenica 2004.g.
3. Hadžikadunić M. Balta S.: Korekcija držanja tijela kod djece predškolskog uzrasta, Sarajevo 2000.g.
4. Šošć.H. (1998): Vodić za pisanje stručnih i naučnih radova u kineziologiji, Sarajevo: Fakultet za fizičku kulturu;
5. Rushiti.H, Gllareva.I, Halilaj.B. (2023) Statusi i rritjes fizikedhe zhvillimit lëvizorëtë fëmijëve të ciklit të mesëm të ulët në shtatë regjionet e kosovës. Konferenca e IV Ndërkombëtare në Ed. Fizik, sport dhe Shëndet, UP FEFS Prishtinë.
6. Rushiti.D, Halilaj.B , Rushiti.H, (2024). Disa parametra të zhvillimit trupor dhe lëvizor tek nxënësit e moshës 12-13 vjeçare të shkollës fillore “elena gjika” nga Prishtina. Konferenca e 9 Ndërkombëtare në Shkencat Sportive, Tetovë <http://www.unite.edu.mk>
7. Berndt, J., Stroeve. F.&Tiesler. G (2003): Biopsychologisches Praktikum: Bremen: Uni Bremen: Biomedizinisches Labor / FB 11
8. Raouf Ebada K. (2003.g.) Die Probleme des Trainings von Geëichthebern im Kindes und Jugendalter (Dissertation); Goettingen
9. Hadžikadunić.M., Rađo.I., Grozdanić.B. & Turković.S (2000): Priručnik za testiranje u nastavi tjelesnog i zdravstvenog odgoja, Sarajevo: FFK
10. Najšteter Đ.(1998): Kineziološka didaktika,Univerzitetaska knjiga; Sarajevo
11. Oja P, Tuxëorth B, eds. (1995)Eurofit for Adults: Assessment of Health-Related Fitness. Finland: Council of Europe Publishing;;1-13.
12. Pavlin, K., Z. Šimenc, K. Delija (1982). Analiza pouzdanosti i faktorske valjanosti situaciono – motoričkih testova u rukometu, odbojci, košarci i nogometu. Kineziologija, 14 (5): 177-187."

13. Burimet nga interneti:

14. http://pedagogskapraksa.ucoz.com/_ld/0/55_normativizaeuro.pdf od 17.1.2015.godine

